


DEPISTIME ONKOLOGJIKE
AUSL MODENA

PARANDALIMI MUND TË TË SHPËTOJË JETËN



SERVIZIO SANITARIO REGIONALE
EMILIA-ROMAGNA
Azienda Unità Sanitaria Locale di Modena



MULTILINGUAL VERSION

Translated Material / materiali i përkthyer
المواد المترجمة / matériel traduit
materiał przetłumaczony / material tradus
ПЕРЕВЕДЕННЫЙ МАТЕРИАЛ / 已译材料

Materialet e shkarkueshme në faqe
www.ausl.mo.it/screening

Merr pjesë në programin e depistimitin
për parandalimin e tumoreve:

- **KOLOREKTALE**
për meshkuj dhe femra
të grupmoshës 50-69 vjeç
- **të GJIRIT**
për femra
të grupmoshës 45-74 vjeç
- **të QAFËS SË MITRËS**
për femra
të grupmoshës 25-64 vjeç



PARANDALIMI MUND TË TË

SHPËTOJË JETËN.

Merr pjesë në programet e depistimit kolorektale, të gjirit dhe

për parandalimin e tumoreve të qafës së mitrës

PËRSE TË MARRËSH PJESË?

- Sa më herët kryhet diagnoza, **aq më efikase dhe më pak invazive** do të jenë trajtimet
- Lezionet kolorektale dhe të qafës së mitrës mund të identifikohen dhe të trajtohen kur janë ende në formë parakanceroze, **duke i parandaluar që të zhvillohen në tumore**
- Ekzaminimet e depistimit i besohen **personelit të kualifikuar dhe ekspert** që përdor aparatura të cilat u përgjigjen standardeve të parashikuara të cilësisë
- Vizitat janë **plotësisht falas**, ashtu si edhe ekzaminimet e mëtejshme dhe të thelluara nëse është nevoja

KUJT I DREJTOHET?

Të gjithë qytetarëve dhe banorëve dhe rezidentëve të asistuar në krahinën e Modenës.

Popullata e interesit është:

- **për depistimin KOLOREKTAL**
ferma e meshkuj të moshave mes 50 dhe 69 vjeç.
Kur? Çdo 2 vjet
- **për depistimin MAMOGRAFIK**
femrat e moshave mes 45 dhe 74 vjeç.
Kur? Çdo vit për grupmoshën 45-49 dhe çdo dy vjet për grupmoshën 50-74
- **për depistimin e QAFËS SË MITRËS**
PAP TEST çdo 3 vjet për grupmoshën 25-29 vjeç,
HPV TEST çdo 5 vjet për grupmoshën 30-64 vjeç

SI TË MARRËSH PJESË?

Personat që u përkasin grupmohave të parashikuara do të marrin një letër-ftesë të personalizuar me ditën, orën dhe vendin e shënuar se ku të kryejnë ekzaminimin e depistimit. Për depistimin kolorektal do të marrin në shtëpi një kit të plotë me epruvetë për prelevimin e mostrës së feçeve, si dhe udhëzimet e prelevimit dhe të dërgimit.

Qytetarët që dëshirojnë të marrin pjesë, por që nuk e kanë marrë ftesën, që e kanë humbur apo që kanë nevojë për informacion, mund të kontaktojnë:

në numrin e gjelbër 800 300 315

ose të dërgojnë email në adresën
screeningoncologici@ausl.mo.it

